

KONVENTA Nr. 81

Konventa qe ka te beje me Inspektimin e Punës ne industri e tregeti

Data e hyrjes ne fuqi: 7 prill 1950

Konferenca e Përgjithëshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, dhe

Mbledhur në Sesionin e 30-të të saj më 19 Qershor 1947, dhe

Pasi ka vendosur mbi miratimin e propozimeve të caktuara në lidhje me Organizimin e Inspektimit të Punës në industri e tregëti, që është pika e katërt e rendit të ditës së Sesionit, dhe

Duke vendosur që këto propozime të marrin formën e një Konvente ndërkombëtare.

Miraton më 11 Korrik 1947, konventën e mëposhteme që mund të quhet si Konventa e Inspektimit të Punës, 1947

Pjesa I

Inspektimi i punës në industri

Neni 1

Çdo Anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës për të cilin Konventa është në fuqi do të mbajë një sistem të inspektimit të punës në ambientet e punës industriale.

Neni 2

1. Sistemi i inspektimit të punës në ambientet industriale do të zbatohet për të gjitha vendet e punës në lidhje me të cilat kushtet ligjore që lidhen me ambientin e punës si edhe mbrojtjen e punëtorëve gjatë punës, janë vendosur nga inspektorët e punës.
2. Ligjet e aktet nenligjore kombëtare mund të përjashtojnë sipërmarrjet e minierave e transportit ose pjesë të tyre nga zbatimi i kësaj Konvente.

Neni 3

1. Funkcionet e sistemit të inspektimit të punës do të jenë:
 - a) të sigurojë zbatimin e ligjeve që lidhen me kushtet e punës e

mbrojtjen e punëtorëve gjatë punës, që lidhen me orët, pagat, sigurinë, shëndetin, mirëqenien, punësimin e femijëve e të rinjve si edhe çështje të tjera që lidhen me të, kur këto ligje zbatohen nga inspektorët e punës.

- b) të furnizojë me informacion teknik e keshillime punëdhësit e punëtorët përsa i përket mjeteve me efektive të pajtimit me këto ligje.
- c) t'i bëjë të ditur autoritetit kompetent objektet ose abuzimet jo të mbuluara nga ligjet ekzistuese.

2. Nëse funksione të tjera u besohen inspektorëve të punës, këto nuk duhet të bëhen pengesë në ushtrimin e funksioneve të tyre kryesore as të dëmtojnë në një mënyrë të çfarëdoshme autoritetin ose paanësinë e nevojshme për inspektorët e punës në marrëdhëniet e tyre me punëdhënësit dhe punonjësit.

Neni 4

1. Përsa kohe është i pajtueshem me praktikën administrative të Anëtarit, inspektimi i punës do të vendoset nën kontrollin e mbikqyrjen e autoritetit qendror.

2. Në rastin e një shteti federal, termi "autoritet qendror" mund të thotë ose autoritet federal ose qendror i një njesie të federuar.

Neni 5

Autoriteti kompetent do të bëjë rregullimet e duhura për të rritur:

a) bashkëpunimin efektiv midis shërbimeve të inspektimit e shërbimeve të tjera qeveritare e institucioneve private apo publike që marrin pjesë në aktivitete të ngjashme.

b) bashkëveprimin midis zyrtarëve të inspektoriatit të punës e punëdhënësve apo punëtorëve e organizatave të tyre.

Neni 6

Stafi i inspektimit do të përbehet nga zyrtarë publikë, statusi i të cilëve dhe kushtet e shërbimit janë të tilla sa që të sigurojnë stabilitet në punësim e janë të pavarura ndaj ndryshimeve qeveritare dhe ndikimeve të jashtme të papershtatshme.

Neni 7

1. Duke iu nënshtuar ndonjë kushti për rekrutim tek shërbimi publik

që mund të pershkruhet si ligj ose akt nenligjor kombëtar, inspektorët e punës do të rekrutohen vetëm në baze të aftësive të tyre në kryerjen e detyrave.

2. Mjetet për të vërtetuar këto aftësi do të përcaktohen nga autoriteti kompetent.

3. Inspektorët e punës do të trajnohen në mënyrë të përshtatshme për të kryer detyrat e tyre.

Neni 8

Edhe gratë edhe burrat do të jenë të përshtatshëm për t'u caktuar si staf inspektimi, aty ku është e nevojshme, detyra të vecanta mund t'u caktohen burrave e grave inspektore.

Neni 9

Çdo Anëtar që do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që ekspertët e specialistë teknikë të kualifikuar, përfshirë këtu specialistë mjeksie, inxhinjerie, elektriciteti, kimie, përfshihen në punën e inspektimit, në mënyrë të tillë që të jete sa më e përshtatshme në kushtet kombëtare, për qëllimin e sigurimit të zbatimit të ligjshmerisë që lidhet me mbrojtjen e shëndetit e sigurisë në punë të punëtorëve e të mbikqyrjes së efekteve të proceseve, materialeve e metodave të punës mbi shëndetin e sigurimin e punëtorëve.

Neni 10

Numri i inspektorëve të punës do të jete i mjaftueshëm për të siguruar shkarkimin efektiv të detyrave të inspektoriatit e do të përcaktohet në baze të:

- a) rëndësisë së detyrave që kanë për të kryer inspektorët, në veçanti
 - (i) numrin, natyrën, madhësinë dhe situatën e vendeve të punës që do t'i nënshtrohet inspektimit,
 - (ii) numrin dhe klasat e punëtorëve të punësuar në këto vende punë,
 - (iii) numrin dhe kompleksitetin e ligjeve që do të zbatohen,
- b) mjetet materiale të vendosura në dispozicion të inspektorëve,
- c) kushtet praktike nën të cilat vizitat e inspektimit duhen kryer që të jenë efektive.

Neni 11

1. Autoriteti kompetent do të beje rregullimet e nevojshme për pajisjen e inspektorëve të punës me:

- a) zyra e lokale të pajisura në mënyrë të pershtatshme në përputhje me kërkesat e shërbimit dhe ku të hyjnë të gjithë personat e interesuar,
- b) lehtësira transporti të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre në rastet kur lehtësira publike të pershtatshme nuk ekzistojnë.

2. Autoriteti kompetent do të beje rregullimet e nevojshme për t'iu rimbursuar inspektorëve të punës ndonjë shpenzim udhëtimi ose të rastit që mund të jetë i nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 12

1. Inspektorët e punës që janë të pajisur me kredencialet e duhura do të autorizohen:

- a) të hyjnë lirshëm e pa lajmëruar me parë në çdo orë të dites ose nates në vende punë që do t'i nënshtrohen inspektimit,
- b) të hyjnë ditën aty ku kanë shkaqe të arsyeshme të besojnë se duhet të kryejnë inspektim, dhe
- c) të kryejnë ndonjë ekzaminim, test, ose hetim që mund të konsiderojnë të nevojshëm me qëllim që të bindin veten se kushtet ligjore po mbikqyren rreptësisht, e në veçanti:
 - (i) të marrin në pyetje vetëm ose në prani të dëshmitarëve, punëdhënesin ose stafin e sipërmarrjes mbi ndonjë çështje që ka të bëjë me zbatimin e kushteve legale,
 - (ii) të kërkojnë prodhimin e librave, regjistrave ose dokumentave të tjera, mbajtja e të cilave përshkruhet nga ligjet e aktet nenligjore kombëtare që lidhen me kushtet e punës me qëllim që të shihet se ato janë në përputhje me ligjet e për të kopjuar keto dokumenta ose për të nxjerre ekstrakte nga ato,
 - (iii) të zbatojnë postimin e lajmërimeve që kerkohen nga kushtet legale,
 - (iv) të marrin ose zhvendosen për qëllime analizash mostra materialeve e substanca që përdoren duke lajmëruar punëdhënesin ose përfaqësuesin e tij për çdo mostër ose substancë të marrë për këtë qëllim

2. Me rastin e nje vizite inspektimi, inspektoret do të lajmërojnë punëdhënesin ose përfaqësuesin e tij, për prezencën e tyre, në rast se ata e konsiderojnë të nevojshme për kryerjen e detyrës.

Neni 13

1. Inspektoret e punës do të autorizohen të ndërmarrin veprime për të riparuar defekte që vihen re në uzina, në hartimin e planit ose metodat e punës ku mund të kenë shkaqe të besueshme se ato përbejnë kërcënim për shëndetin ose sigurinë e punëtorëve.
2. Me qëllim që të nxiten inspektoret për të ndërmarrë hapa të tilla, ata do të autorizohen duke iu nënshtruar çdo të drejtë apeli tek një autoritet administrativ ose juridik, që mund të garantohet me ligj, të bëjnë ose jo porositë që kërkojnë:

- a) ndryshime të tilla tek instalimi ose uzina që duhen kryer brenda një kohe limit të përcaktuar, të nevojshme për të siguruar përputhje me ligjet që lidhen me shëndetin ose sigurimin e punëtorëve, ose
- b) masa me forcë të menjëhershme ekzekutuese kur ka rrezik të dukshëm të shëndetit ose sigurisë së punëtorëve.

3. Aty ku procedurat e përshkruara në paragrafin 2 nuk pajtohen me praktikën administrative ose juridike të Anëtarit, inspektoret do të kenë të drejtën t'i drejtohen autoritetit kompetent për nxjerrjen e urdhrave ose për marrjen e masave me forcë ekzekutuese të menjëhershme.

Neni 14

Inspektoriati i punës do të lajmërohet për aksidentet industriale si edhe rastet e sëmundjeve profesionale në raste e mënyra të tilla siç përshkruhet nga ligjet e aktet nenligjore kombëtare.

Neni 15

Duke iu nënshtruar përcaktimeve të bëra nga ligjet kombëtare e aktet nenligjore, inspektoret e punës:

- a) do të ndalohen të kenë interes direkt ose indirekt në sipërmarrjet që kanë nën kontroll,
- b) do t'i nënshtrohen gjobave të caktuara ose masave disiplinuese, nëse nxjerrin, pasigëllojnë shërbimin, ndonjë sekret prodhues ose tregëtar, ose proces punë që mund ta mesojnë gjatë kryerjes së

- detyres, dhe
- c) do të trajtojnë si plotësisht konfidenciale burimin e ndonjë ankese që iu behet e ditur në lidhje me ndonjë shkelje në ligjshmeri e nuk do të njoftojë punëdhënesin ose përfaqësuesin e tij për kryerjen e një vizite inspektimi si pasoje e kësaj ankese.

Neni 16

Vendet e punës do të inspektohen aq shpesh sa të jete e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të ligjshmerise perkatese.

Neni 17

1. Personat që shkelin ose lenë pas dore rregulloren e përcaktuar nga inspektorët e punës do t'i nënshtrohen procedurave ligjore pa paralajmërim: me kusht që përjashtimet mund të behen nga ligje kombetare ose akte nenligjore në baze të rasteve ku ishte lajmëruar me parë për kryerjen e masave parandaluese ose rregulluese.
2. Do të lihet në gjykimin e inspektorëve të punës për të dhënë paralajmërime ose këshillime në vend të ndërmarrjes ose rekomandimit të procedurave.

Neni 18

Gjopa të përshtatshme për shkeljen e rregulloreve të zbatuara nga inspektorët e punës dhe për pengimin në kryerjen e detyrave të inspektorëve do të përcaktohen nga ligje e akte nenligjore kombetare e do të zbatohen me efektivitet.

Neni 19

1. Inspektorëve të punës ose zyrtarë lokalë të inspektimit, sipas rastit do t'u kërkohej t'i nënshtrohen autoritetit qendror të inspektimit me raporte periodike mbi rezultatet e aktivitetit të tyre të inspektimit.
2. Këto raporte do të hartohen në këtë mënyrë e do të trajtojnë probleme të tilla si të jenë përshkruar here pas here nga autoriteti qendror. Ata do të dorëzohen aq shpesh sa e përshkruajnë autoritetet e në asnjë rast më pak se 1 herë në vit.

Neni 20

1. Autoriteti qendror i inspektimit do të botojë një raport të përgjithshëm vjetor mbi punën e shërbimeve të inspektimit nën kontrollin e vet.
2. Raporte të tilla vjetore do të botohen brenda një kohe të

aresyeshme pas fundit te vitit me te cilen lidhen keto raporte, e ne ndonje rast brenda 12 muajve.

3. Kopje raportesh vjetore do t'i transmetohen Drejtorit te Pergjithshem te Zyrës Ndërkombëtare te Punës brenda nje periudhe te aresyeshme pas publikimit te tyre e ne ndonje rast brenda 3 muajve.

Neni 21

Raporti vjetor i botuar nga autoriteti qendror i inspektimit do të trajtoje ceshtjet e meposhteme e te tjera te lidhura me to per aq kohe sa ato te jene nen kontrollin e autoritetit ne fjale.

- a) ligjet e aktet nenligjore te lidhura me punën e sherbimit te inspektimit,
- b) stafin e sherbimit te inspektimit te punës,
- c) statistikat e vendit te punës qe i nenshtrohet inspektimit e numrin e punëtoreve te punësuar aty,
- d) statistikat e vizitave te inspektimit,
- e) statistikat e shkeljeve te gjobave te vena,
- f) statistikat e aksidenteve industriale,
- g) statistikat e semundjeve profesionale.

Pjesa II

Inspektimi i punës ne tregeti

Neni 22

Çdo Anëtar i Organizatës Ndërkombëtare te Punës, per te cilin kjo pjese e kesaj Konvente eshte me fuqi do të mbaje nje sistem te inspektimit te punës ne tregeti.

Neni 23

Sistemi i inspektimit në punë në ndërmarrje tregtare zbatohet në ato ndërmarrje për të cilat inspektorët e punës janë të ngarkuar të sigurojnë zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë në kushtet e punës dhe me mbrojtjen e punonjësve në ushtrimin e profesionit të tyre.

Neni 24

Sistemimi i inspektimit te punës ne tregeti do të veproje ne perputhje me kerkesat e neneve 3 deri ne 21 te kesaj Konvente per aq kohe sa jane te zbatueshme.

Pjesa III

Rregulla te ndryshme

Neni 25

1. Çdo Anëtar i Organizatës Ndërkombëtare te Punës qe ratifikon kete Konvente, mund te perjashtoje pjesen II te kesaj Konvente nepermjet nje deklarate bashkangjitur ratifikimit te tij.
2. Çdo Anëtar qe ka bere nje deklarate te tille mund ta anulloje ate ne cdo kohe nepermjet nje deklarate pasuese.
3. Çdo Anëtar, per te cilin nje deklarate e bere nen paragrafin 1 te ketij neni eshte ne fuqi, do të tregojë cdo vit ne raportin e tij vjetor mbi zbatimin e kesaj Konvente, pozicionin e ligjit te tij e praktikës ne baze te rregullave te pjeses se dyte te kesaj Konvente, dhe shtrirjen e efektit te dhene ose te propozuar per keto rregulla

Neni 26

Ne ndonje rast ku ka dyshime ne lidhje me ndonje sipermarrje, pjese ose sherbime sipermarrjesh ose vend pune, ku zbatohet kjo Konvente, ceshtja do të vendoset nga autoriteti kompetent.

Neni 27

Ne kete Konvente termi "rregulla ligjore" perfshin shtese ne ligje e akte nenligjore, arbitrame e marreveshje kolektive mbi te cilat shtrihet forca e ligjit e qe jane te detyrueshme nga inspektorët e punës.

Neni 28

Do të perfshihet ne raportet vjetore per t'ia nenshtruar nenit 22 te Kushtetutes se Organizatës Ndërkombëtare te Punës, informacioni i plote qe ka te beje me ligjet e aktet nenligjore ku behen efektive kushtet e kesaj Konvente.

Neni 29

1. Ne rastin e nje Anëtari, territori i te cilit perfshin zona te medha, ku per shkak te popullsise se rralle ose stadiit te zhvillimit te zones, autoriteti kompetent e konsideron te papraktikueshem zbatimin e kushteve te kesaj Konvente, autoriteti mund t'i perjashtoje keto zona nga zbatimi i kesaj Konvente ne pergjithesi ose me perjashtime te tilla ne lidhje me sipermarrjet ose profesionet e caktuara qe mendohen te

pershtatshme.

2. Çdo Anëtar do të tregojë në raportin e tij të parë vjetor mbi zbatimin e kësaj Konvente nën nenin 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ndonjë zone që propozon t'i rikthehet kushteve të nenit në fjale, duke dhënë arsyet e këtij propozimi. Asnjë Anëtar nuk do të lejohet t'i rikthehet ketyre rregullave pas dates së raportit të tij të parë vjetor, me përjashtim të zonave të treguara.

3. Çdo Anëtar që i është rikthyer kushteve të nenit në fjale do të tregojë në raportet vjetore pasuese, zonat, ku ai heq dorë nga e drejta për t'ju drejtuar rregullave të mesiperme.

Nenet 30-31

Deklarata e zbatimit në territore jashtë kryeqytetase.

Pjesa IV

Dispozitat përfundimtare

Nenet 32-39

Dispozitat standarte përfundimtare.